

## Shkolla fillore

- Shkolla fillore është **shkolla e parë** që fëmijët ndjekin **pas kopshtit** në Gjermani.
- Zakonisht fillimi i shkollës festohet. Kjo quhet **Ceremonia e Fillimit të Shkollës**. Shumicën e rasteve **çdo fëmijë mban një kon shkollë**. Ajo ka një formë koni dhe prej letre të trashë. Ajo mund të mbushet me stilolapsa dhe ëmbëlsira. Do të pyes në shkollën e fëmijës për datën e fillimit të shkollës.
- Që **ditën e parë të shkollës** fëmijët vijnë me çantat e tyre të shkollës. Ndonjëherë është bërë zakon që me vete të merret edhe koni i shkollës.
- Zakonisht fëmijët bëjnë 4 vjet në shkollë fillore. **Nga moshë 6 vjeç** duhet që të gjithë fëmijët në Gjermani të shkojnë në shkollë. Ky quhet **arsimi i detyrueshëm**. Arsimi i detyrueshëm është pjesë e ligjit të arsimit në landin e Baden-Württemberg. Ndjekja e kopshtit është me dëshirë, por e shkollës është e detyrueshme. Ndjekja e shkollës është e detyrueshme.
- **Të gjitha shkollat fillore në Baden-Württemberg kanë të njëjtat qëllime**. Megjithatë, mënyrat e mësimdhënies, orët mësimore, lëndët, ... mund të jenë të ndryshme.
- Kur fëmijët shkojnë në shkollë dinë shumë dhe mund të bëjnë gjëra të ndryshme. Qëllimi është: **Në fund të shkollës fillore të gjithë fëmijën duhet të dinë dhe bëjnë njësoj**.
- Në shkollën fillore nxënësit mësojnë si të **numërojnë, lexojnë dhe shkruajnë**. Në shkollën fillore jepen **dijet bazë**. Të rëndësishme janë po edhe **lëvizja, këndimi, ngjyrimi, punëdoret dhe aktivitetet e përgjithshme**. Kështu nga shkolla fillore hidhen në shkollat më të larta të pajisur me njohuritë e nevojshme.
- **Në shkollën fillore nxënësit mësojnë edhe si mëson njeriu në përgjithësi**. Ata mësojnë metoda të ndryshme, si të marrin informacione dhe t'i përpunojnë ato. Fëmijët e shkollës fillore mësojnë **vetëm dhe në grup**.
- Në shkollën fillore ekziston mundësia e pjesëmarrjes në **orën e fesë**. Për këtë e marr unë vendimin për fëmijën tim. Në shkollë mund të pyes se për çfarë fesh jepet mësim. Nëse fëmija im i përket një feje dhe shkolla ofron mësim për këtë fe, atëherë fëmija im është i detyruar të ndjekë mësimet.
- Në disa shkolla mësimi zhvillohet vetëm paradite. Në **shkollat ditore** fëmijët qëndrojnë aty së paku deri në orën 15:00. Prandaj në shkollë jepet edhe drekë, e cila paguhet nga prindërit. Numri i orëve mësimore është njësoj si në shkollat e tjera. Në pjesën tjetër të kohës bëhen detyrat e shtëpisë, hahet së bashku, zhvillohen sporte, ...

- Në disa shkolla fillore ka **orë mësimore korigjuese**. Në këtë orë mësimore marrin pjesë fëmijët që janë mbi 6 vjeç, por që u është shtyrë ndjekja e shkollës fillore. Ata përgatiten aty për t'u pranuar në klasën e parë të shkollës fillore.
- Fëmijët nga familjet refugjate ose emigruese kanë mundësinë të ndjekin një **klasë përgatitore në një shkollë të formimit të përgjithshëm**. Kjo njihet shkurtimisht si VKL. Aty ata mund ta mësojnë gjermanisht në mënyrë më intensive. Qëllimi është që këta fëmijë të integrohen sa më shpejt në jetën shkollore.